



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

V E N D I M

Nr. 35, Datë 24.03.2016

MBI

FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2016

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Byroja Shqiptare e Sigurimit më datë 25.02.2016, ka depozituar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS, nr. 08, datë 09.02.2016. Sipas këtij vendimi është propozuar krijimi i Fondit të Kompensimit për vitin 2016, i ndarë në dy komponentë:

Shuma prej 468,126,732 lekë – për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit deri më datë 31.12.2013;

Shuma minimale prej 20,000,000 lekë - për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit nga data 1 janar 2014 e në vazhdim.

Shuma prej 468,126,732 lekë, është propozuar në vijim të zbatimit të vendimit të Bordit nr. 17, datë 28.02.2014, “Mbi Fondin e Kompensimit të vitit 2014”, sipas të cilit është vendosur shlyerja e detyrimeve për 3 vite, përkatësisht 2014, 2015 dhe 2016.

Por Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 2281, datë 18.03.2016, informon se vlera e dëmeve pezull për dëmet objekt i fondit të kompensimit me ngjarje sigurimi pas datës 1 janar 2014, është në vlerën 116,310,245 lekë.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Për vitin 2016, Fondi i Kompensimit për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull me datë ngjarje sigurimi deri në 31.12.2013, të jetë në vlerën 468.126.732 lekë, sipas pikës 1 dhe 2 të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit nr. 08, datë 09.02.2016.**

- 1.1 Byroja Shqiptare e Sigurimit të bëjë ndarjen e praktikave të dëmeve duke patur parasysh periudhën më të hershme të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, të cilat duhet të fillojnë nga viti 2002 e në vijim.**
- 1.2 Byroja Shqiptare e Sigurimit të shpërndajë menjëherë praktikat dhe të autorizojë për pagesë duke patur me prioritet praktikat me ngjarjet e sigurimit më të hershme.**
- 2 Fondi i Kompensimit për vitin 2016, me qëllim pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, të jetë minimalisht në vlerën 116,310,245 lekë. Byroja Shqiptare e Sigurimit të bëjë ndarjen e praktikave të dëmeve të shoqëritë e sigurimit, si dhe të bëjë ndarjen e kësaj vlere sipas përcaktimeve të nenit 45, pika 2, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009.**
- 3 Byroja Shqiptare e Sigurimit të bëjë rakordimet për pagesat dhe detyrimet objekt i Fondit të Kompensimit, sipas pikës 2, të këtij vendimi çdo tre muaj.**
- 4 Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI